

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar në bazë të njoftimit për përqendrim të parashtruar nga shoqëria **Kostal Betajlingsgesellschaft2 mbH (Kostal Beteiligungsgesellschaft 2 mbH)**, me adresë të regjistruar në An der Belmeraj 10, 58513 Lidenshtajd, Gjermani, përmes avokatit Bozhidar Millosheviq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 23.06.2023,

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin shoqëria **Kostal Betajlingsgesellschaft2 mbH (Kostal Beteiligungsgesellschaft 2 mbH)**, me adresë të regjistruar në An der Belmeraj 10, 58513 Lidenshtajd, Gjermani, do të fitoj kontroll të pavarur mbi pjesë të caktuara të operacioneve të biznesit dhe mjeteve të **Kompleo Çarxhing Solushns AG** (Compleo Charging Solutions AG), me seli në Eceshtrase 8, 44379 Dortmund, Gjermani, nëpërmjet blerjes së aksioneve në shoqëritë e varura përkatëse të **Kompleo Çarxhing Solushns AG** dhe palëve të lidhura me të, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksa administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbartimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 26.05.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga **Kostal Betajlingsgesellschaft2 mbH (Kostal Beteiligungsgesellschaft 2 mbH)**, me adresë të regjistruar në An der Belmeraj 10, 58513 Lidenshtajd, Gjermani (në tekstin e mëtejshëm: **Kostal**), me të cilën **Kostal** do të fitoj

kontroll të pavarur mbi pjesë të caktuara të operacioneve të biznesit dhe mjeteve të Kompleo Çarxhing Solushns AG (Compleo Charging Solutions AG), me seli në Eceshtrase 8, 44379 Dortmund, Gjermani, nëpërmjet blerjes së aksioneve në shoqëritë e varura përkatëse të Kompleo Çarxhing Solushns AG dhe palëve të lidhura me të.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

KOSTAL është një kompani familjare me bazë në Lidenshtajd, është një furnizues ndërkombëtar i zgjidhjeve elektronike, elektromekanike dhe mekatronike për një gamë të gjerë të automobilave dhe destinime të tjera industriale. Shoqëria punëson rreth 19,000 njerëz në 21 vende në 53 lokacione.

KOSTAL është i ndarë në katër reparte:

- 1-KOSTAL –elektrikë për makina (KOSTAL Automotive Electrics),
- 2-KOSTAL –elektrikë për industri (KOSTAL Industrial Electrics),
- 3-KOSTAL-sisteme për kontakt (KOSTAL Contact Systems) dhe
- 4-COMA- testim për inxhinieri (SOMA Test Engineering).

Transaksioni ka të bëjë kryesisht me sektorin e industrisë elektrike, fushat kryesore të biznesit të të cilit janë fotovoltaiçet, kontrollet e makinës dhe elektronika e matjes dhe kontrollit.

Portofoli i produkteve përfshin solar, bateri dhe inverterë hibridë, një pajisje matës inteligjente si një aksesor për matjen dhe kontrollin e konsumit të energjisë personale dhe softuer të përshtatshëm për monitorimin e fotovoltaiçëve.

KOSTAL ka një shoqëri të regjistruar në Maqedoninë e Veriut:

KOSTAL MAKEDONIJA SHPKNJ Ohër (me seli në fshatin Kosel 6000, Ohër dhe aktiviteti i regjistruar 29.31 - Prodhimi i pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete), e cila ka një fabrikë prodhuese në Ohër.

Kompleo është një kompani e listuar në bursën e Frankfurtit, me seli në Dortmund, Gjermani. Është një ofruer shërbimi gjithëpërfshirës i harduerit dhe softuerit për teknologjitë e karikimit të automjeteve elektrike.

Portofoli i produkteve harduerike përfshin zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e rrymës alternative (AC) dhe rrymës direkte (DC), stacioneve të karikimit publik dhe gjysmë publik.

Në këtë drejtim, Compleo ofron stacione karikimi standard DC, stacione të karikimit të shpejtë DC dhe (që pritet të lançohet deri në fund të këtij viti) një stacion karikimi ultra të shpejtë.

Për më tepër, Kompleo ofron zgjidhje dhe shërbime softuerike të bazuara në cloud për operatorët e infrastrukturës publike dhe gjysmë publike për karikim. Kjo përfshin softuerin e

operatorit të stacionit të karikimit dhe zgjidhjet e marketingut për operacionet tregtare. Në një masë të kufizuar, Kompleo gjithashtu ofron të ashtuquajturat shërbime të lëvizshmërisë elektronike (EMP) për drejtuesit e automjeteve elektrike. Këto përfshijnë, në veçanti, një aplikacion pagese për stacionet e karikimit dhe mënyrat e pagesës direkte nëpërmjet pagesës online.

Biznesi i synuar që po blihet përbën biznesin e Kompleo me softuer dhe një pjesë të madhe të biznesit të Kompleo me harduer.

Kompleo nuk është i regjistruar në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски

